



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 223 par.1 të Ligjit Nr. 02/I-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, si dhe nenit 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerrë:

V E N D I M

**PËR NDALIM QARKULLIMIN E AUTOMJETEVE ME PESHË MË TË
MADHE SE 7.5 t PREJ HYRJES SË RRUGËS SË GURORES DERI TE
UDHËKRYQI TE SHKOLLA "ERNEST KOLIQI" BABUSH – GADIME**

Neni 1

Ndalohet qarkullimi i të gjitha automjeteve me peshë më të madhe se 7.5 ton prej hyrjes së rrugës së gurores deri te udhëkryqi te shkolla "Ernest Koliqi" Babush – Gadime e Ulët me përjashtim të atyre të cilat transportojnë mallëra për nevoja të banorëve të rrugës, mjeteve të transportit publik si dhe atyre të shërbimeve publike.

Neni 2

Në rrugën e cekur sipas nenit 1 të këtij Vendimi do të vendosen shenjat përkatëse mbi ndalimin e qarkullimit.

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohet Stacioni Policor i Kosovës në Lipjan, Drejtorati për Inspektorat, Drejtorati për Shërbime Publike dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të njoftohet Drejtorati për Inspeksion – Inspektorët komunal të trafikut dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

INr. 346-20497
Lipjan, më:29.05.2014

Kryetari i Komunës
Imri Ahmeti

